

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Data: 08.07.2022

Numri i vrojtimit të lejes:

07 Nr.400/350-33099

- Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit e Komunës së Suharekës në bazë të kërkesës së z. Kujtim Mazreku nga Suhareka, Komuna Suharekë, me 07 Nr. 350-33099 të datës 03.06.2022 - në të cilën kërkon dhënien e lejes për vendosjen e tavolinave lëvizëse, gjegjësisht shfrytëzimin e tokës shoqërore para lokalit të tij afarist, në bazë të nenit 8 aline 8.9 pika 8.9.1 të Rregullores për Tarifat, Ngarkesat dhe Gjobat nga Shërbimet dhe Veprimtarit Komunale - 01 Nr. 16-12102 të datës 01.12.2015 dhe Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike dhe private 01-Nr.16-4719 të datës 30.06.2016 si dhe Procesverbalit 07Nr.311/350-33099 të datës 22.06.2022, nenit 44, 47, 48 dhe 125 të LPPA -së bie këtë:

PËLQIM

Ky dokument lëshohet për:			
Emri:	Kujtim Mazreku	Nr. Personal:	
Adresa:	“Piano Bar One”Shpk. Rr.“Brigada-123“- Suharekë.	Telefoni:	
Email :		Kërkesa Bazë:	Pëlqim-për shfrytëzim të hapsirës publike për vendosjen e ombrellave dhe tavolinave lëvizëse.

Përshkrimi:

I LEJOHET - investuesit - z. **Kujtim Mazreku** nga Suhareka, Komuna Suharekë, vendosja e tavolinave dhe ombrellave lëvizëse ose mbulojës lëvizëse të fiksuar për objekti për hijezim të lokalit dhe platos para lokalit të tij afarist **“Piano Bar One”Shpk., si dhe shfrytëzimin e hapsirës publike** në një sipërfaqe prej **20m²**, në rrugën “Brigada-123” në Suharekë, në ngastrën kadastrale Nr. 01100-0, pronë shoqërore, kom. kad. Suharekë.

Vendosja e tavolinave, mbuloja e platosë me mbulesë lëvizëse ose ombrella, si dhe shfrytëzimi i sipërfaqes së tokës shoqërore - hapsirës publike - **lejohet me karakter të përkohshëm sezonal** dhe vlen nga data **22.06.2022** deri më **31.10.2022**, me mundësi të vazhdimit pas shqyrtimit të rrethanave të reja të krijuara dhe dispozitave tjera ligjore.

Shfrytëzuesi do të shfrytëzojë platonë në një sipërfaqe prej **20.00 m²**, për të cilën do të paguaj sipas Rregullores së Komunës së Suharekës për shfrytëzimin e pasurisë - tokës shoqërore, dhe atë **3 euro për m² në muaj**, shuma për pagesë prej **22.06.2022** deri me **31.10.2022** është gjithsejtë : **258,00 Euro**.

Investuesi obligohet që sipërfaqen e cila i jepet në shfrytëzim ta mirëmbajë pastër.

Gjithashtu hapësira e cila i jepet në shfrytëzim nuk lejohet të kufizohet (rrethohet).

Trotuari duhet të jetë i lirë dmth. shfrytëzimi i sipërfaqes së lejuar duhet të shfrytëzohet në atë mënyrë që të mos e pengon lëvizjen e lirë të qytetarëve (këmbësorëve) në trotuar.

Për nevoja më të mëdha të realizimit të planit urbanistik të asaj pjese të Suharekës, ku lejohet shfrytëzimi i kësaj hapësire për vendosjen e përkohshme të objekteve të cituara më lartë, investuesit edhe para skadimit të afatit të caktuar me këtë Pëlqim mundet të i bihet Aktvendimi për mënjanimin e objekteve në fjalë, pa kurrfarë kompensimi nga ky Organ e në shpenzime të vet investuesit.

Me rastin e festave kombëtare, tubimeve dhe për nevoja të tjera nga drejtoria e Urbanizmit - jeni të obliguar që objektet e cekura më lartë ti menjanoni për një kohë të caktuar.

Nëse ka ankesa nga ana e fqinjëve përshkak të zhurmës apo pengesave tjera të arsyeshme të banorëve për rreth, atëherë do të merren masa konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Investuesi është i obliguar që më së paku 30 ditë para skadimit të afatit të këtij Pëlqimi të parashtroi kërkesë të re për zgjatjen e afatit për shfrytëzimin e hapsirës publike.

Për mos kryerje të punëve sipas këtij Pëlqimi , inspekcioni përkatës do të veproj sipas rregullave të parapara me ligj .

Ky Pëlqim pushon të vlej nëse investuesi nuk i vendos këto brenda afatit të ciktuar në këtë Pëlqim.

A r s y e t i m

Duke e shqyrtuar kërkesën e investuesit z. **Kujtim Mazreku** nga Suhareka, Komuna Suharekë, ky Organ konstatoi se kërkesa është e arsyeshme dhe se të përmendurit mundet të i lejohet vendosja e tavolinave dhe ombrellave lëvizëse ose **mbuloja lëvizëse** e fiksuar për objekti si dhe shfrytëzimi i hapsirës publike - tokës shoqërore para lokalit të tij afarist "Piano Bar One"Shpk., në një sipërfaqe prej **20.00 m²**, me afat të caktuar me këtë Pëlqim .

Kërkesës i është bashkangjitur dëshmia mbi pagesën e rregullimit të tokës ndërtimore.

Kërkesës i është bashkangjitur edhe dëshmia mbi pagesën e Pëlqimit për vendosjen e objekteve të përkohshme dhe shfrytëzim të hapsirës publike konform Rregullores mbi tarifat dhe ngarkesat 01 Nr. 16-12102 të datës 01.12.2015 - sipas nenit 8. pika 8.8.5.- në vlerë prej **15.00 euro**.

Udhëzime Juridike : Kundër këtij Pëlqimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese - MMPHI-së Prishtinë, përmes kësaj drejtorie, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtit.

Pëlqimi i dërgohet:

-Parashtruesit të kërkesës, Inspektorit Komunal dhe dosjes së DUP-it.

Zyrtari përgjegjës :
Agron Bajraktari

Drejtori i Drejtorisë:
Visar Kuçi

